



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.59, datë 27.07.2022

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“HOTEL PORT SIDE” ME 2-5 KATE MBI TOKË DHE 1-4 KATE NËNTOKË, ME
VENDNDODHJE NË BASHKINË SARANDË

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të zhvilluesve Z. Frederik Hadëri dhe Znj. Fatmira Hadëri, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: ““Hotel Port Side”, me 2-5 kate mbi tokë dhe 1-4 kate nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Sarandë, me zhvillues Z. Frederik Hadëri dhe Znj. Fatmira Hadëri.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë, bashkëlidhen si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDHAMA



Nënshtuar më datë 15/05/2024

SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILIMIT TERRITORIT
ADELAJDA ROKA
AGJENCIA E ZHVILIMIT TERRITORIAL
MINISTRI E TIRANË

MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUMBARO-FURXHI
REPUBLIKË E TIRANË
MINISTRI E TIRANË